



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISTINA

FAKULTETI I NDËRTIMTARISË – CIVIL ENGINEERING FACULTY

Rr. Agim Ramadani, ndërtesa e "Fakultetit Teknik", 10000 Prishtinë, Kosovë  
Tel: +383-38-548 644 URL: <http://www.fna.uni-pr.edu> Mail: [fn@uni-pr.edu](mailto:fn@uni-pr.edu)

Ref. nr. 43/A Prishtinë 06.01, 2023

PUBLIKIMI I ABSTRAKTIT TË PUNIMIT TË DIPLOMËS MASTER

DEPARTAMENTI HIDROTEKNIK

Studenti **Edon Morina** ka dorëzuar dorëshkrimin e punimit të diplomës Master me titull: " **Kërcënimet në lumbardhin e Deçanit dhe vlerësimi i potencialit për restaurimin e tij** " në programin e studimeve Hidroteknik dhe dorëshkrimi është në procedurë të vlerësimit përfundimtar deri në vendimin e këshillit të Fakultetit të Ndërtimtarisë. Sipas rregullores për studimet Master Shkencor të Universitetit të Prishtinës, abstrakti i shkurtër i punimit të diplomës bëhet publik për periudhën kohore prej pesë ditësh nga dita e shpalljes.

Ky punim diplome trajton kërcënimet dhe vlerësimin e potencialit për restaurimin e Lumbardhit të Deçanit. Restaurimi i lumenjve shfrytëzohet për të rigjeneruar gjendjen e shkatërruar të tyre dhe për të penguar dëmtimin e parashikuar në të ardhmen si pasojë e zhvillimit të sipërfaqes përgjatë brigjeve të lumit, shfrytëzimit të lumenjve për furnizim për qëllime të ndryshme dhe nxerjes së resurseve inerte në lumë.

Me anë të këtij punimi shkencor mendohet të ofrohen mënyrat më të përshtatshme për restaurimin e këtij lumi, metoda këto që shfrytëzohen në vendet më të zhvilluara të botës, e të cilat nëse aplikohen drejtë dhe në përputhje me qëllimet që synohen të arrihen në pellgun përkatës janë shumë efikase për të kthyer gjendjen e shkatërruar të lumit në gjendjen e tij natyrore.

Para se të vendoset për mënyrat e restaurimit janë analizuar kërcënimet të cilat e kanosin lumin. Në Lumbardhin e Deçanit janë të ndërtuara katër hidrocentrale të vogla (Lumbardhi 2, Lumbardhi, Deçani dhe Belaje). Si pasojë e ndërtimit të tyre, lumi ka pësuar ndryshime të mëdha hidrogjike dhe hidromorfologjike dhe si rezultat i kësaj ka ardhur deri tek shkatërimi i ambientit përgjatë lumit, shtjerrim i lumit dhe rrezikimi i botës shtazore dhe bimore. Ndërsa pjesa e lumit prej 1km është kanalizuar me materiale joadekuate, duke ndikuar në ndryshimin e proceseve fizike, hidrogjike dhe kimike në lumë. Përveç kësaj, ky lumë i është nënshtruar edhe shfrytëzimit të zhavorit nga shtrati i tij, duke e rënduar edhe mëtej gjendjen e lumit.

Gjatë fazës hulumtuese për lumin, në fillim është menduar të bëhet një shpjegim i përgjithshëm i pellgut të lumit, është treguar gjendja ekzistuese e tij, janë analizuar karakteristikat hidromorfologjike dhe hidrogjike, janë shtjelluar kërcënimet aktuale prezente dhe ato që parashihen të ndodhin si rezultat i projekteve të ardhshme në pellg.

Në fund është diskutuar në lidhje me potencialin që ka pellgu për restaurim dhe janë dhënë diskutimet, përfundimet dhe rekomandimet në lidhje me gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme në lidhje me problemet me të cilat përballet lumi.

Fjalët kyçe: restaurimi i lumenjve, Lumbardhi i Deçanit, kërcënimet, ndërtimi i digave, gjendja ekzistuese, potenciali për restaurim.

Dorëshkrimi i punimit është i atashuar në sekretarinë e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe është i qasshëm për publikun. Çdo vërejtje, plotësim, ndryshim mund të deponohet me shkrim i protokolluar dhe do të merret për trajtim nga këshilli i Fakultetit të Ndërtimtarisë.